



### **3 Bashkim familjar (tek shtetasi zviceran ose i huaji me leje qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm)**

**Qëllimi:** Për personat të cilët janë të kurorëzuar me shtetas të huaj ose zviceran dhe dëshirojnë të jetojnë tek bashkëshorti/ bashkëshortja dhe për fëmijët e mitur të cilët dëshirojnë të jetojnë tek prindi në Zvicër që kanë leje qëndrimi B, C, F ose shtetasi Zvicerane.

**Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.**

**Ta keni parasysh se:**

- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet drejtpërdrejt në ambasadë.
- Ju duhet t'i sillni dokumentat personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosiet e pakompletuara nuk pranohen.

**► Dokumentet e nevojshme:**

- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 2 kopje;
- 2 kopje të pasaportës së bashkëshortit/-es në Zvicër si dhe 2 kopje e lejëqendrimit të tij /saj.
- Certifikata e lindjes origjinal me gjendjen civile para kurorëzimit në certifikatë;
  - I/e ndarë: + fletëshkurorëzimi dhe dokumenti i gjendjes civile në të cilin përmendet shkuroëzimi origjinal.\*
  - I/e ve: + certifikata e vdekjes e bashkëshortit/-es paraprak/-e
- Certifikata e vendbanimit origjinal.\*
- Certifikata e bashkësisë familjare origjinal.\*
- Formulari „Pyetje shtesë lidhur me bashkimin familjar“, i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër
- Fletëshkurorëzimi origjinal.
- Kurorëzimi të të miturit (nën 18 vjeç); Vendimi i gjyqit për lejimin e martesës (me vulë apostile).\*
- Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë (me vulë apostile).\*

**Dokumente shtesë për fëmijët e mitur:**

- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 2 kopje;
- 2 kopje të pasaportës së prindit në Zvicër + 2 kopje e lejëqendrimit të tij / saj.
- Certifikata e lindjes origjinal
- Nëse fëmija është lindur jashtë martese, pranimin e atësisë origjinal (procesverbali)\*
- Certifikata e vendbanimit origjinal\*
- Certifikata e bashkësisë familjare origjinal\*
- Në rast se njëri prej prindërve jeton në Shqipëri: ai duhet të jetë prezent gjatë dorëzimit të dokumenteve të fëmijës dhe ta japëpëlqimin me shkrim që fëmija të shkojë për të jetuar në Zvicër përgjithmonë (një deklaratë nga gjykata nuk pranohet). Prindi duhet ta sjellë me vete një letërnjoftim të vlefshëm;

**INFORMATA TË RENDËSISHME:**

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- \* Të gjitha dokumentet të cilat janë vetëm në gjuhë shqipe duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentat e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Personi i cili jeton në Zvicër duhet të sqaron drejtpërsëdrejti me zyrën kompetente të migracionit nëse përveç aplikimit për vizë duhet të bëhet edhe një aplikim i brendshëm. Informacione të mëtejme mund të merren nga zyra kantonale e migracionit.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Formularët merren falas në sportelin e Ambasadës Zvicerane.

**Të gjitha dokumentet shqiptare duhet ta kenë vulën apostile të ministrisë së punëve të jashtme të shqipërisë.**



## Qendra Regjionale Konsullore për Ballkanin Perëndimor c/o Ambasada Zvicerane në Kosovë

### Informata të përgjithshme:

- Vetëm aplikuesit me termin të caktuar i lejohet hyrja tek sporteli.
- Vendimet merren vetëm nga autoritetet e kantonit apo të shtetit federal në Zvicër.
- Për informata shitesë: [www.eda.admin.ch/westbalkan](http://www.eda.admin.ch/westbalkan)

### Si caktohet termimi:

1. **Caktimi i terminit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasaden tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: [pri.visa@eda.admin.ch](mailto:pri.visa@eda.admin.ch). Ju lutëm të bashkangjiti **një kopje të skenuar dhe të lexueshme të pasaportës të secilit person që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar.**
2. **Dorëzimi i dokumentave :** Përmbajuni udhëzimeve në lidhje me terminin dhe siguroni të gjitha dokumentat e nevojshme. Ejani në ambasadë në ditën dhe kohën e terminit tuaj.
3. **Marrja e vendimit :** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër. Bashëshorti/ja – prindi në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të hënës deri të premtën prej orës 8:00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.

**Terminet caktohen në menyrë kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka termine me prioritet).**

### Orari i punës i sektorit konsular:

Dorëzimi i aplikimit:

vetëm me termin

e hënë - e premte

### Pagesat për aplikim:

60 € për të rritur

35 € për fëmijë 6 -12vjeç

Pa pagesë për fëmijët nën moshën 6 vjeçare.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shitesë administrave.
- Paratë e pageses nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).

### Kujdes nga Agjencitë

- Gjithë ata që ofrojnë shërbime jashtë rrethojave të zeza nuk i përkasin stafit të ambasadës.
- Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me asnje agjenci jashtë ndërtesës së vet.
- Stafit i Ambasadës Zvicerane nuk ka kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.
- Ambasada Zvicerane gjendet në hapësirat e kufizuara me rrethoja të zeza.
- Ambasada Zvicerane i jep formularët pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane jep informata pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane nuk rekomandon asnjë kompani të sigurimeve.

### Kini parasysh se Ambasada Zvicerane:

- Nuk pranon aplikim pa termin të caktuar.
- Nuk jep informata (me telefon apo email) për kërkesat e parashtruara.
- Ka të drejtë:
  - ° të kërkojë dokumenta shitesë.
  - ° ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
  - ° t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
  - ° ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.